

"EUROGREN" Sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	78,053	27,455
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	-	-
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	3,881,200	3,946,201
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	6,179,774	6,494,493
Inventarë	8	87,100	87,100
Total aktive afatshkurtra		10,226,127	10,555,249
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	18,456,721	18,456,721
Aktive afatgjatë jomateriale	10	1,568,700	1,568,700
Kapitali aksionar i pa paguar		1,494,000	1,494,000
Total aktive afatgjatë		21,519,421	21,519,421
Total aktive		31,745,548	32,074,670
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	328	328
Detyrime tatimore	12	23,515	23,514
Të tjera detyrime	13	331,737	331,737
Total detyrime afatshkurtra		355,580	355,579
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	33,785,658	33,666,651
Provizione		152,398	152,398
Total detyrime afatgjatë		33,938,056	33,819,049
Total detyrime		34,293,636	34,174,628
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	15	51,760,627	51,760,627
Fitime të mbartura		(53,860,585)	(52,467,661)
Rezultati i ushtrimit		(448,130)	(1,392,924)
Total kapitali		(2,548,088)	(2,099,958)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		31,745,548	32,074,670

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	1,920,000	1,920,000
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera		(805,349)	(258,873)
1) Të tjera shpenzime	17	(805,349)	(258,873)
Shpenzime të personelit	18	(1,050,300)	(1,050,300)
1) Paga dhe shpërblime		(900,000)	(900,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(150,300)	(150,300)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime / të ardhura financiare neto	19	(189,008)	(1,842,417)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(2,273,888)	(2,307,150)
2) Fitime nga përkthimet valutore		2,084,880	464,733
Fitimi/humbja para tatimit		(124,657)	(1,231,590)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20	(323,473)	(161,334)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(323,473)	(161,334)
Fitimi/humbja e vitit		(448,130)	(1,392,924)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(448,130)	(1,392,924)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali i nënshkruar	Humbje të mbartura	Fitim / humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2017	51,760,627	(50,311,537)	(2,156,124)	(707,034)
Fitimi / Humbja e vitit			(1,392,924)	(1,392,924)
Levizje përmes kapitalit		(2,156,124)	2,156,124	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	51,760,627	(52,467,661)	(1,392,924)	(2,099,958)
Fitimi / Humbja e vitit			(448,130)	(448,130)
Levizje përmes kapitalit		(1,392,924)	1,392,924	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	51,760,627	(53,860,585)	(448,130)	(2,548,088)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i EUROGREN Sh.p.k më 25.03.2019 dhe janë firmosur si më poshtë.

Z. Edmond Mersini

Z. Edmond MERSINI
 Administrator

Mazars Shpk

Mazars Sh.p.k
 Hartues i Pasqyrave Financiare



Rr. Emin Duraku, Pall. "Bijaketi",
 No.5, 1000, Tirana, Albania
 phone : +355 42 27 80 15
 www.mazars.al, info@mazars.al



EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Rezultati i ushtrimit	(448,130)	(1,392,924)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	189,008	1,842,417
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	323,473	161,334
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	56,247	(480,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	120,598	130,827
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(70,000)	(150,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(70,000)	(150,000)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	50,598	(19,173)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	27,455	46,628
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 78,053	27,455

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Eurogren" sh.p.k është regjistruar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim gjykatë të rrethit Tiranë Nr.11574 datë 01.05.1996 në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë tregtare", si edhe nga statuti i saj.

Ortakët e shoqërisë janë:

- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që zotëron 29% të kapitalit;
- Z.Edmond Mersini që zotëron 23.68% të kapitalit;
- Z.Hasan Hafizi që zotëron 23.66% të kapitalit;
- Znj. Mirela Mula që zotëron 23.66% të kapitalit.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhim, përpunim, tregtim, eksportim dhe importim të detaleve gjysëmfabrikate prej druri, të lëndëve drusore të gjithëfarlojshme të sharruar, artikujve të tornuar e të profiluar, makinerive të përpunimit të drurit, organizimit dhe kryerjes së shërbimit të transportit për mallrat e ndryshëm dhe pasagjerë, të ushqimit social etj.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. "Konferenca e Pezës", Nd.73, H.1, Njësia nr.6, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me Kod Fiskal 3705911 dhe NIPT J61814077J.

Më 31 dhjetor 2018 shoqëria kishte 2 punonjës (31 dhjetor 2017: 2 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur.

Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/ LEK	107.82	111.10

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar njihet me vlerën nominale. Kuotat (pjesët) e zotëruara nga ortakët e shoqërisë klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Automjetet	Vlera e mbetur	20%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7 Qirate (vazhdim)

ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në bankë	64,715	14,117
Llogari rrjedhëse	64,715	14,117
Mjete monetare në arkë	13,338	13,338
	78,053	27,455

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë	15,307,674	15,307,674
Zhvierësim i llogarive të arkëtueshme	(15,307,674)	(15,307,674)
	-	-

Lëvizjet në zhvierësimin e të drejtave për arkëtim detajohen më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjendja më 1 janar	15,307,674	15,307,674
Gjendja më 31 dhjetor	15,307,674	15,307,674

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Emped shpk	3,881,200	3,946,201
	<u>3,881,200</u>	<u>3,946,201</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shteti – TVSH për tu marrë	36,734	36,734
Tatim fitimi	1,319,248	1,633,967
Të tjera	4,823,792	4,823,792
	<u>6,179,774</u>	<u>6,494,493</u>

8. Inventarë

Inventari i shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Produkte dhe mallra	5,725,175	5,725,175
Të tjera gjendje inventari	87,100	87,100
Provizione për zhvlerësime	(5,725,175)	(5,725,175)
	<u>87,100</u>	<u>87,100</u>

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtesa	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2016	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Amortizimi i vitit	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Amortizimi i vitit	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173

Vlera neto kontabël

Gjendja më 31 dhjetor 2016	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 dhjetor 2018	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lek)

10. Aktivet afatgjata jomateriale

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
Me kosto		
Gjendja me 31 dhjetor 2017	4,980,000	4,980,000
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2018	4,980,000	4,980,000
Amortizimi		
Gjendja me 31 dhjetor 2017	3,411,300	3,411,300
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2018	3,411,300	3,411,300
Gjendja neto më 31 dhjetor 2017	<u>1,568,700</u>	<u>1,568,700</u>
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	<u>1,568,700</u>	<u>1,568,700</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë vendas	328	328
	<u>328</u>	<u>328</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	20,915	20,914
Tatimin mbi të ardhurat personale	2,600	2,600
	<u>23,515</u>	<u>23,514</u>

13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga për t'u paguar	64,000	64,000
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	267,737	267,737
	<u>331,737</u>	<u>331,737</u>

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

14. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Hua nga ortakët	33,785,658	33,666,651
	33,785,658	33,666,651

15. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 51,760,627 i ndarë në 100 kuota.

Gjatë vitit 2018 nuk kanë ndodhur ndryshime në kompozimin e kapitalit të shoqërisë.

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga qiraja	1,920,000	1,920,000
	1,920,000	1,920,000

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në e Tatim Fitimit	
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	1,920,000
Zbriten autofaturimet	-
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	1,920,000
Fitim nga kembimet valutore	2,084,880
Të ardhura nga interesat	-
Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim Fitimit	4,004,880

(Vlerat janë në Lek)

17. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Taksa te ndryshme lokale	739,720	202,679
Konsulenca ekonomike dhe juridike	48,000	48,000
Kamatvonesa	7,255	-
Komisione bankare	7,100	6,100
Energji Elektrike	2,074	894
Shpenzime Administrative	1,200	1,200
	<u>805,349</u>	<u>258,873</u>

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Paga dhe shpërblime	900,000	900,000
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore	150,300	150,300
	<u>1,050,300</u>	<u>1,050,300</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2018 është 2 punonjës (2017: 2 punonjës).

19. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	(2,273,888)	(2,307,150)
Fitime nga përkthimet valutore	2,084,880	464,733
	<u>(189,008)</u>	<u>(1,842,417)</u>

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin detajohet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	(124,657)	(1,231,590)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	2,281,143	2,307,150
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	7,255	-
Shpenzime interesash të panjohura	2,273,888	2,307,150
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	2,156,486	1,075,560
	2,156,486	1,075,560
Tatim fitimi 15%	323,473	161,334
Rezultati i ushtrimit	(448,130)	(1,392,924)

21. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Hasan Hafizi	11,261,886	11,222,217
Edmond Mersini	11,261,886	11,222,217
Mirela Mula	11,261,886	11,222,217
	33,785,658	33,666,651
	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të pagueshme arkëtueshme nga palët e lidhura		
Emped Shpk	3,881,200	3,946,201
	3,881,200	3,946,201

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Transaksionet		
Shitje		
Emped shpk	1,920,000	1,920,000
	1,920,000	1,920,000

22. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

23. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.